

Pse duhet të vaksinohemi?

Personat të cilët nuk janë të vaksinuar kundër fruthit për shkak të gjendjeve të caktuara shëndetësore ose sepse nuk e kanë arritur moshën për vaksinim, rrezikohen nga zhvillimi dhe përhapja e sëmundjes.

VAKSIMI ËSHTË MËNYRA MË E MIRË PËR TA MBROJTUR VETEN DHE TË TJERËT!

Disa fakte:

- ▶ Në periudhën 2000-2015, vaksinimi kundër fruthit në nivel global ka shkaktuar një rënie të vdekshmërisë për 79%!
- ▶ Në të njëjtën periudhë 15-vjeçare, vaksinimi kundër fruthit parandaloi rreth 20,3 milion vdekje, duke e bërë vaksinën kundër fruthit një nga masat më të mira shëndetësore publike!

The MMR vaccine



Sigurohuni që fëmija juaj të pranojë të gjitha vaksinat:

- ▶ Kontrolloni kartelën e vaksinimit / librezën e shëndetësisë ose kërkoni ndihmë nga mjeku juaj amë!
- ▶ Nëse fëmija juaj nuk është i vaksinuar në kohë sipas moshës, **MENJËHERË** dërgojeni atë pranë Shërbimit për vaksinim për ta vaksinuar!

MËNYRA MË E MIRË PËR TA MBROJTUR FËMIJËN TUAJ NGA FRUTHI ËSHTË VAKSINIMI KUNDËR KËSAJ SËMUNDJEJE, SEPSE VAKSINIMI ËSHTË MASA MË E SUKSESHME PREVENTIVE!

Organizata Botërore e Shëndetësisë, në rrafsh global ka vendosur qëllimin për eliminimin e fruthit deri në vitin 2020!!!

Fruthi dhe si të mbrohemi



Instituti i shëndetit publik



INFORMATË PËR POPULLATËN

Çfarë është fruthi?

Fruthi (morbili) është një nga sëmundjet më ngjitëse që shkaktohet nga një virus (morbili virus).

Cilat janë simptomat?


Simptomat me të cilat karakterizohet kjo sëmundje:

- temperaturë trupore mbi 39°C,
- rraskapitje,
- dhimbje koke,
- dhimbje dhe kruarje në fyt
- kollë e thatë, rrjedhje hundësh,
- skuqje, sy të ënjtur dhe të përlotur dhe
- një iritim karakteristik i lëkurës dhe mukozave. Iritimi fillon nga koka (pas veshëve, pjesa me flokë, fytyra, qafa), e që përhapet poshtë nëpër të gjithë trupin, në pëllëmbët e duarve dhe shputave (si ujë nga dushi). Enantema në mukozën e zgavrës së gojës dhe qiellzës së butë duket si kokrriza të shpërndara të grurit.




Si përhapet sëmundja?

Sëmundja përhapet nëpërmjet ajrit, me pikat e vogla të sekrecionit nga rrugët e frymëmarrjes, e cilat gjatë kollitjes, teshtitjes apo gjatë të folurit me zë të lartë i hedhin nga goja njerëzit e sëmurë apo të infektuar.



Burimi i sëmundjes është i sëmururi, 4 ditë para sëmundjes dhe 4 pas paraqitjes së skuqjes. Virusi transmetohet shumë lehtë nga personi në person, më shumë se 90% e atyre që kanë qenë në kontakt me pacientin do të sëmuren nëse nuk janë vaksinuar ose nuk janë sëmurë me sëmundjen.



Virusi mund të mbijetojë deri më 2 orë në ambient të hapur (sipërfaqe, gjësende e tj.) që mundëson përhapjen indirekte të tij (mjete të sapo kontaminuara, lodrat e fëmijëve, sipërfaqe pune).

Komplikimet e mundshme:

Komplikimet më të shpeshta të kësaj sëmundjeje janë: pezmatimi i veshit të mesëm, pezmatimi i rrugëve të frymëmarrjes dhe mushkërive, shfaqja e verbërisë, inflamacioni i trurit dhe i cipave të trurit, por mund të ketë si rezultat edhe vdekjen si pasojë e komplikimeve të rënda. Sëmundja më shpesh i rëndon më shumë fëmijët në moshë deri në 5 vjet ose të rriturit mbi 20 vjet.

► Në vitin 2015, nga komplikimet e fruthit në mbarë botën kanë vdekur 134.200 njerëz – rreth 367 vdekje për çdo ditë ose 15 vdekje për çdo orë!

► Vlerësimi i OBSH-së në vitin 1980, para përhapjes së aplikimit të vaksinimit kundër fruthit, tregon se nga kjo sëmundje kanë vdekur rreth 2,6 milionë fëmijë në mbarë botën!

Si trajtohen të sëmurët?

Nuk ka terapi specifike për fruthin. Trajtimi është simptomatik dhe në rast të ndërlikimeve kryhen metoda të ndryshme të trajtimit.

Pas infeksionit nga kjo sëmundje personi i prekur fiton imunitet të përherëshëm.